



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0027425-1/24 dt. 30.04.2024
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e 31-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 30.04.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Hamdi Hasani, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Nafije Rexha, Lavdim Zeneli, Mentor Vinarci, Faruk Mujka, Naser Muja, Hysen Muzliukaj, Jeton Zeneli, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Shkurta Shosholli Musa, Xhevrije Bahtiri Ademi, Erseka Barani, Xhylljeta Imeri, Sevdaim Uka, Gazmend Asllani, Oltion Ahmeti, Muhamed Hoti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri, Ardita Aliu

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Flutura Beka Kamberaj, Elidiana Budini Haziri, Kushtrim Zeneli.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 31-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje. Po ashtu në material e keni marrë edhe pikën shtesë, Raportin vjetor të Drejtorisë së Shëndetësisë për periudhën janar-dhjetor 2023 e cila ju ka bashkëngjitur një ditë pasi që e keni marrë ftesën për Kuvend si dhe para vetes e keni prapë kërkesën e përsëritur nga seanca e kaluar për mbështetje financiare, të sindikatës së të punësuarve në Komunën e Mitrovicës, cilat sot do t'i propozoj si pika shtesë të futen në rendin e ditës. Hap për diskutim për rend të ditës.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Znj. Kryesuese, pyetja është pikërisht për juve, ne para disa seancave e kemi marrë një vendim unanimisht në Kuvend për blerjen e veshmbathjeve sportive për mësimdhënësit e edukatës fizike dhe asnjëherë nuk është fol më për këtë çështje. Ne kishim një garë të futbollit edhe Drejtoresha ishte prezentë, unë pyeta se çka ka ndodhur me vendimin që është marr në Kuvend për blerjen e veshmbathjeve sportive për mësimdhënësit e edukatës fizike të cilin u marr ajo më tha bleni vet ose jua blen shkolla ndërsa unë e di që ai vendim u marr dhe

mjetet është dashtë mu nda për atë vendim që është marr po nuk është bë asgjë, andaj unë sot kërkoj një sqarim.

Kryetari Bedri Hamza: Znj. Bahtiri Ademi, keni shumë të drejtë dhe kërkoj falje për këtë sepse Vendimi i cili merret në kuvend duhet të zbatohet dhe unë e marrë përgjegjësin për zbatimin e këtij vendimi. Këtu në prani të gjithëve po ju them drejtorëve se vendimet e Kuvendit janë të zbatueshme edhe të padiskutueshme për kryetarin atëherë janë gjithsesi edhe për ta.

Xhafer Preteni: Përshëndetje për të gjithë, unë e kam një propozim për subvencionimin e botimit të librit të dokumentaristit më të njohur të Kosovës z. Ilaz Bylykbashi me titullin "555+". Libri është një kronologji e ngjarjeve kryesore që kanë ngjarë prej marsit të vitit 1981 deri më mars 1999. Libri është hartuar, siç kanë ndodhur ngjarjet historike me rreth 1,400 fotografi origjinale që i ka bërë fotoreporteri-dokumentaristi më i njohur i Kosovës, e që ka bërë emër në botë, z. Ilaz Bylykbashi. Fotografitë janë dokumentare, të pa prekura-ashtu siç janë bërë fotografitë, kryesisht në teknikën bardhë e zi e një pjesë më e vogël edhe me ngjyra. Fotografitë prezantojnë ngjarjet duke filluar nga demonstratat e vitit 1981, gjykimet politike ndaj shqiptarëve, shtypja në heshtje e shqiptarëve, propaganda serbe, shkatërrimi i arsimit, shkatërrimi i shtëpive të shqiptarëve nga regji i serb, rrënimi i autonomisë, zbarkimi ushtarako-policor i Serbisë në Kosovë, koordinimi i shqiptarëve për mbijetesë kundër dhunës serbe, prezantimi dhunës ndaj fëmijëve dhe vrasja e tyre, mbylljen e shkollave, dëbimet nga shtëpitë, masakrat e mëdha, etj..

Një kapitull i tërë, me fotografi dokumentare nga të gjitha ngjarjet në Kullat e Jasharajve, është prezantuar dhe përshkruar, e tërë epopeja e udhëhequr nga ideologu, atdhetari dhe strategu Shaban Jashari, duke pasur në krahë gjeneralët e tij Ademin e Hamzën, dhe tërë familjen e vënë në ballë të betejave që nga vitit 1991 deri në rënien e tyre heroike. Në këtë kapitull z. Ilaz Bylykbashi, ka sjell fotografitë origjinale dhe të vetmet që në tërësi e faktojnë atdhetarinë e Jasharajve, shumë beteja të një Luftë të pashembullt në Botë. Pa fotografitë e Ilaz Bylykbashit (të ilustruara me tekst në gjuhën shqipe dhe angleze), kurrë, nuk do të dihet kjo pjesë e historisë shqiptare. Libri ilustrohet me tekst në gjuhën shqipe dhe angleze. Libri është i dizajnuar në formatin A4, dhe i ka gjithsej 700 faqe. Vlera e subvencionimit është 15,000 €. 500 kopje, çmimi i tregut do të sillet diku në 30 deri në 35 € për kopje, andaj unë e kisha propozuar që të gjendet forma më e mirë e mundshme që ta subvencionojmë këtë libër dhe ti bëjmë nder komunës tonë, sepse Ilaz Bylykbashi nuk i takon komunës tonë, është fotoreporter që vjen prej Gjilani, mirëpo e ka pasqyrua krejt ngjarjet në Kosovë çka kanë ndodhur.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Për z. Ilaz Bylykbashi nuk kemi nevojë me fol gjatë, se e dimë të gjithë për periudhën të cilën e përfshin e tha edhe z. Preteni, është një periudhë prej vitit 1981 që i përfshin gjykimet politike gjithë periudhën e viteve tetëdhjeta ngjarjet e minatorëve pastaj periudhën e rezistencës paqësore të viteve të nëntëdhjeta, fotografi për aktivitetin e asaj periudhe duke përfshi presidentin Rugova dhe gjithë aktivistët tjerë, periudhën e luftës pra është një thesar i cili për shkak të gjendjes shëndetësore z. Bylykbashi, ekziston mundësia që me mbet i pa botuar edhe i pa sistemuar. Mendoj që kemi obligim të gjithë ndaj këtyre zhvillimeve, aty ka fotografi që nuk janë pa asnjëherë në publik dhe do të jenë për herë të parë që do të shihen në publik. Jam i vetëdijshëm që është një kosto, po mendoj që në raport me vlerën, të cilën e posedon edhe e ka ky material mjetet financiare nuk duhet me qenë problem për botimin e tij. Unë, se përket aspektit financiar, d.m.th Komuna e Mitrovicës sigurisht se ka mundësi me bë një financim të tillë dhe si sponsor dhe i botimit të këtij materiali, do të jetë logo dhe emri i Komunës sonë andaj mendoj që është vlerë edhe për neve si komunë që të jemi sponsor i një thesarit të tillë, po megjithatë është në diskrecionin edhe në autoritetin e anëtarëve të Asamblesë që ta përkrahin me votë këtë propozim, që të na mundësojnë neve ligjërisht që të mos bëjmë pjesë e objektit të auditimit për shkak të një procedure, mirëpo po flasim për një periudhë kohore prej vitit 1981 deri në vitin 2000, domethënë realisht unë e kam taku z. Bylykbashi po e përsëris se nuk është me

shëndet të mirë por sido që të jetë unë i uroj shëndet dhe jetë të gjatë por ajo se qfarë kërkoj është që ne si shtet, si institucion, duhet me qenë të kujdesshëm që me njerëz të caktuar mos të na shkoj edhe historia. Prandaj, po ju lus me mirëkuptim, me mirësjellje, që këtë propozim ta përkrahim që të kemi mundësi në mënyrë të rregullt procedurale ta përkrahim botimin e këtij materiali gjithmonë po them si sponsorizues, me logo dhe emër të komunës së Mitrovicës.

Faruk Mujka: Ne nuk jemi kundër librit, mirëpo është mirë me i sqarua disa paqartësi fillimisht, e para në qoftë se paguhet prej subvencioneve unë e di që ligji nuk e lejon me pagua dikë që nuk është banori i Komunës së Mitrovicës dhe e dyta, në qoftë se e subvencionojmë këtë libër, ai libër mandej ish dashur mu shpërnda falas. Pra ky libër a shpërndahet falas apo mandej e ka një çmim, nuk e di sa është e drejtë me sponzoru me e shtypë një libër i cili mandej ka impakt financiar. Domethënë kjo madje mbetet tek ju me e sqarua, por sa i përket neve nuk ka asnjë telashe, normalisht është nder për me sponsorizua një libër të tillë, i cili fakton, sepse ne si komb gjithmonë ankohe mi që e kemi problem me faktimin e historisë dhe kjo është veç një hap në këtë drejtim, pra askush gjë kundër nuk kemi, veç t'i sqarojmë edhe këto dy-tre çështje.

Vesel Neziri: Jam i bindur se edhe herave tjera kur kam biseduar për çështje faktike, për gjëra që janë të rëndësishme edhe për kombin e veçmas kur bëhet fjalë për librat, unë sot po mendoj se është një ndër propozimet më të mira që ka ardhur në Kuvend. Mënyra dhe rruga se si gjendet, kisha pas dëshirë që mos me pas pengesa ligjore, e përgëzoj z. Preteni për propozimin dhe unë besoj se kuvendi nuk do të ketë asnjë dilemë që këtë libër ta subvencionojë, mirëpo të shihet rruga ligjore dhe ato që i tha z. Mujka qëndrojnë, pra të shohim se si do të mund ta realizojmë këtë dhe është kënaqësi e madhe në qoftë se na si komunë do të arrijmë që këto fotografi t'i nxjerrim në dritë për opinionin edhe të brendshëm edhe të jashtëm.

Gazmend Asllani: Unë para gjashtë muajve kam kërkuar një raport nga Drejtoria për kulturë rini e Sport dhe ende s'kam kurrfarë përgjigje e as raport, ku është problemi? a mundem me më njoftua. Unë e di që ka pas ndryshime në këtë drejtori, por të presim me muaj për një raport është shumë. Nëse s'ka raport është mirë të na thuhet nuk ka raport, një përgjigje e kemi marr po unë kam kërkuar një raport të detajuar për rrjedhën e krejt procedurës se si ka ardhur deri te përfundimi i vendosjes së tribunës, po ashtu kam kërkuar edhe nga Drejtoria e Urbanizmit se a ju është dhënë leja për ndërtim të asaj tribune. Pra përgjigje nuk kam marr as nga Drejtoria e Urbanizmit. Pra unë prapë kërkoj që të na sillen një Raport i detajuar nga DKRS-ja dhe nga DPU-ja. Për drejtoreshën e Arsimit, kam një pyetje në lidhje me bursat për Shkollën e Mesme "Arkitekt Sinani", ku është procesi, a mundë të na tregoni, Vitin e kaluar në këtë kuvend e kemi votuar vendimin për bursat për nxënësit e shkollës "Arkitekt Sinani" dhe ende as një hap nuk është ndërmarr dhe ata nxënës veqse e përfunduan vitin shkollor tash veçse janë maturant. Po ashtu më intereson se pse katër shkolla të qytetit janë pa Sekretarë të shkollave që katër vite, a mundemi me ditë pse? a kërkohet aq shumë kohë për një përzgjedhje të sekretarëve kur të gjithë e dimë se sa janë të nevojshëm sekretarët në shkolla. Pres përgjigje me shkrim meqenëse nuk është drejtoresha prezentë.

Kryesuesja Vesa Broja: Sa i përket raportit, drejtor ju kisha lutur që me marrë informacion për çështje që i ka ngritë z. Asllani. Nëse është e nevojshme, i merr pyetjet edhe në Sekretari, të cilat i ka ngrit atëherë po ashtu edhe tash. Ndërsa sa i përket bursave ne e kemi miratuar Rregulloren për bursa këtu bashkërisht. Ajo Rregullore ka hy në fuqi dhe tash po besoj që drejtoresha fillon me u marrë me formimin e komisionit sepse deri më tani nuk ka pasur mundësi sepse nuk ka pasur Rregullore për me bë përzgjedhjen.

Hysen Muzliukaj: Në mbledhjen e kaluar në procesverbal shkruan: Pas propozimit tim që të sillen një Raport nga Drejtoria e Shëndetësisë, kolegu ynë asamblist z. Kushtrim Zeneli ka ngritë një çështje që të vjen një raport nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, që ta dimë saktë sa fëmijë janë në çerdhet publike e sa në çerdhet private. Zotimi juaj znj. Kryesuese, ka qenë, lexoj: *pikat që u cekën nga zoti Musliukaj dhe z. Zeneli, do të sillen në shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.*

Këtë e citova nga procesverbali, dhe kuptohet që jeni zotuar e nuk na ka ardhur asgjë. Ndërsa sa i përket propozimit të z. Preteni, e përgëzoj dhe qëndroj prapa idesë së shefit të grupit që le të gjendet moduli që vëllimi i parë apo botimi i parë të jetë falas, mbase Komuna e Subvencionon.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë ka ardhur ndërsa raporti i cekur nga z. Zeneli e kemi diskutuar me drejtoreshën, drejtoresha i ka të gjitha të dhënat, numrin e fëmijëve dhe për nënat vetushqyese por janë të dhëna që mbrohen me ligj, por është e gatshme tek pika pyetje dhe përgjigje mu përgjigj në pyetjet e z. Zeneli por edhe të tjerëve.

Hysen Muzliukaj: A mundet pra drejtoresha sot mos të japë të dhëna nëse janë konfidenciale, po të dhënat që janë zyrtare për publikun me na i dhënë sot? Dhe a mundem me u fut në rend dite?

Kryesuesja Vesa Broja: Meqenëse nuk kemi material për këtë pikë unë e theksova edhe më lartë që drejtoresha i ka të dhënat për numrin e fëmijëve dhe për nënat vetushqyese dhe është e gatshme tek pika pyetje dhe përgjigje mu u përgjigj në pyetjet e z. Zeneli por edhe të tjerëve. Pasi nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim e vë në votim propozimin që pikë e 4-të e rendit të ditës të jetë: Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë janar-dhjetor 2023.

Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi propozimin që pikë e 4-të e rendit të ditës të jetë: Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë janar-dhjetor 2023.

Hedh në votim propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës, materialin të cilin e keni secili para vetes.

Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës.

Hedh në votim propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë: Propozimi i z. Preteni për Subvencionimin i botimit të librit të dokumentaristit të njohur në Kosovë Z. Ilaz Bylykbashi

Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë propozimi për Subvencionimin e botimit të librit të dokumentaristit të njohur në Kosovë, Z. Ilaz Bylykbashi.

Kryesuesja në vazhdim vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale
3. Raport financiar për periudhën janar-mars 2024
4. Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë janar-dhjetor 2023
5. Kërkesa për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës
6. Kërkesa për subvencionimin e botimit të librit me titull "555+" të autorit të njohur të Kosovës z. Ilaz Bylykbashi
7. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (28-për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale, për ta arsyetuar të propozimin fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Faruk Mujka: Çështja e transfereve, rialokimit të mjeteve, është bërë më një çështje gati shumë e shpeshtë në Kuvendin tonë edhe po më vjen keq drejtoreshë, po më së pakti ka të bëjë me ndryshimet legjislative apo ligjore por kryekëput ka të bëjë me keq planifikim edhe me mosrealizim të projekteve të parapara me buxhet. Ndryshimet kaq të shpeshta neve na qesin në pozitë tepër të keqe, sepse në shtator ne e votojmë buxhetin, ku në buxhet janë të parapara projektet dhe pastaj na vijnë ndryshimet në janar, në shkurt, në mars, në prill, kjo i bie komplet deformim i buxhetit paraprak i cili është votuar në shtator, po ashtu kjo i bie edhe deformim i vullnetit qytetareve, sepse në buxhetin i cili votohet në shtator, e ku informatat mirën gjatë dëgjimeve buxhetore gjatë muajit korrik, është pasqyrim i kërkesave dhe i vullnetit të qytetarëve. Me këto ndryshime deformohet vullneti i qytetarëve dhe si të them në një far forme ata po mashtrohen sepse ata po janë të lumtur që projektet do të kryhen, fjala është për ato projekte të cilat kanë qenë të planifikuara qoftë fjala edhe për një rrugë, tash prej asaj rruge po i marrim mjetet e po çojmë dikun tjetër si p.sh. po merren mjetet nga një projekti e po dërgohen në projektin tjetër, mirëpo kjo është kompetencë e ekzekutivit dhe përgjegjësinë për këtë pra qytetarëve e merr Kryetari i Komunës. Unë për vete nuk e shoh të arsyeshme pjesëmarrjen time, në ndryshimin kaq të madh të vullnetit të qytetarëve të shprehur nëpërmjet buxhetit të cilën e kemi votuar ma përpara.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Duke e vlerësuar diskutimin e z. Mujka, megjithatë do të bëjë përpjekje me i dhënë disa sqarime. E para, nuk është praktikë e mirë që ligjet, çdo vit të ndryshojnë, është e lejuar, po nuk është praktikë e mirë. Viteve të fundit kemi një ndryshim të vazhdueshëm të ligjit për ndarjet buxhetore, te pjesa tekstuale e ligjit. Është hera e parë që këtë vit futen disa paragraf të ri që për të hyrën vetanake ku ligji për menaxhimin e financave të pushtetit lokal i jep autoritet dhe pavarësi të plotë komunave, që të hyrat vetanake, ti përdor sipas nevojave të veta. Për herë të parë futet paragraf ku të hyrat vetanake të nënshpenzuara apo të tejkaluara komuna nuk ka autoritet me i bartë aty ku ka nevojë. E kuptoj, deri në masë të madhe që të ruhet struktura mes kategorive të shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse, mirëpo është jashtë çdo logjike dhe ka me u tregu jo funksionale që niveli qendror me vendos me t'i bartë mjetet në një projekt, ku kanë qenë vitin paraprak. Nëse ti vitin paraprak e ke përfundua projektin me një rregullim, ti ki tepricë të mjeteve mu në atë projekt, se e ke buxhetua saktë, e ke plotësua, nëse një projekt vitin e kaluar, për një arsye apo një arsye tjetër legale, nuk ka mundur me u zhvillu, rrethanat nuk kanë ndryshua cila është mundësia që mu shpenzua këtë vit dhe ka mundësi që mu përdorë i njëjti mu bartë nëpër shumë vite, për më tepër, nuk ka mundësi më shumë se një herë me bë rirregullimin nëse shfrytëzohet ligji deri në 15%, një herë mundet me ndodhë, aty është limiti. Organizata buxhetore ka të drejtë me vendim të Kuvendit të Komunës me e bë rregullimin deri në 15%, po me aprovim të Ministrisë të financave, nëse është mbi 15%, shkon në Qeveri, nëse është përtej 40% duhet të shkoj në Kuvend. Asnjë projekt i cili është aprovua me buxhetin e vitit 2024 për Komunën e Mitrovicës, nuk është largu, po flasim për të hyrat, të cilat janë të nënshpenzuara. në vitin 2023 dhe po flasim për tejkalimin e të hyrave që janë pasqyrua në raportin që e kemi pas në seancën paraprake. Prandaj, me qëllim që t'i vazhdojmë projektet të cilat kanë kontratë, me qëllim që nuk kemi nevojë të m'i pas 100.000 € të buxhetuara për Rrugën "Lah Nimani" kur e ke të plotësua pra pse me nejtë edhe 100.000 plus, apo në Rrugën "Dëshmorët e Kombit", apo 150.000€ në një projekt që nuk mund të realizohet fare. Prandaj unë duke u bazuar edhe në ligj se s'mund të dalë jashtë ligjit, megjithatë kjo ka e mu verifikua edhe nga MAPL përtej kësaj edhe nga Ministria e

Financave, për shkak se duhet edhe nënshkrimi i Ministrit dhe pa aprovimin e Ministrisë së Financave, ky transfer nuk mundet me ndodh, unë besoj në vullnetin tuaj të mirë. Ju siguroj që asnjë projekt, i cili ka qenë i planifikuar në buxhetin e vitit 2024 nuk është larguar prej buxhetit, por tash po flasim vetëm për të hyrat e bartura nga viti paraprak, që janë prej dy arsyeve: nënshpenzim që domethënë nuk janë shpenzuar dhe e dyta tejkalim në raport me plane, prandaj po ju lus që me përkrah, edhe uroj që këtë vit kemi ekzekutim më të mirë të buxhetit se te viti paraprak. Në disa pjesë jam optimist, në disa edhe unë i kam shqetësimet e mia për shkak se disa projekte të reja për me u nisë, procedurat po janë mjaft komplekse. Pra këto janë procedura s'janë vetëm për neve, janë për gjithë Kosovën dhe ne duhet me i respektua.

Faruk Mujka: Kryetar, unë nuk po kam dëshirë me të keq cituar, por këto dy fjali që i thatë ato i thash edhe unë, në qoftë se teprojnë shumë mjete në një projekt por edhe në qoftë do jete se nuk ka mjete të mjaftueshme në një projekt, kjo i bie që është keq planifikim, këtë e thash edhe unë, tash nëse ju po thoni se pse me ndejtë 100.000 € në projektin e Rrugës "Lah Nimani" kjo i bie që janë keq planifikuar. Po edhe në qoftë se ne i kemi rialoku vitin e kaluar për një projekt disa mjete, d.m.th i kemi planifikua sa mjete duhet të shpenzohen edhe prapë po na teprojnë mjete në atë projekt prapë i bie që është keq planifikim. Unë këtë e thash, pajtohem që nuk është mirë me u ndërrua Ligji, po Ligji nuk na ndalon që tri vite mos me i përfundua punët në Rrugët "Mbretëresha Teutë", "Ali Zeneli", Lah Nimani" etj.

Kryetari Bedri Hamza: Nuk është çështje polemike, nuk është qëllimi aty, kjo nuk lidhet veç me mandatin tim, po edhe me mandatet paraprake, janë të detyruar ekzekutivi me bë procedimin e buxhetit në muajin gusht me saktësi të plotë deri në centin e fundit, është mirë, është e nevojshme, është e dëshirueshme maksimalisht me i bërë, po në muajin gushtë me e ditë saktë se sa kanë me u shpenzua mjete deri më 31 dhjetor në saktësi, po flasim për shumata të mëdha, shumata marramendëse, kjo është bukur vështirë.

Vesel Neziri: Ne kishim shumë paqartësi në KPF derisa u dakordum dhe pamë se ishin të nevojshme. As unë, as z. Mujka, asnjëherë nuk kem dëshirë dhe nuk ia duam të keqen qytetit të Mitrovicës, po kemi dëshirë që projektet të realizohen. Jemi shumë të vetëdijshëm që në Rrugët "Ali Zeneli" dhe "Lah Nimani" jo tri vjet, po se pesë vjet po mundohem me gjet zgjedhje për procedurat, shpronësimet, të gjitha këto janë pengesa që neve s'po na lejojnë me ecë përpara. Në KPF nuk është mirë që prej shkollave të tërhiqen mjetet, por në momentin kur e kuptova se dy herë po dështon tenderi në shkollën e Gjinnazit dhe kisha uruar që kësaj radhe edhe këto që mjete po mbesin aty, që të mund të shfrytëzohen dhe të shpenzohen, por them të drejtën, disa procedura burokratike po na pengojnë shumë për realizimin e shumë projekteve. Pastaj në KPF e kam bë edhe një propozim për vizitë studimore, nuk e di a është përfshi dhe si mund të realizohet kjo, nuk u diskutua më shumë, kisha pas dëshirë me ditë deri ku kemi arrit.

Hysen Muzliukaj: Ato që u thanë nuk po i përsërisim, mirëpo edhe unë në KPF i kam dhënë vërejtjet dhe vlerësimet e mia. Mes asaj që për shkak të procedurave, besoj që kush do që ka punua dhe i njeh procedurat, nuk është bash krejt zi në atë aspekt. Jam dakord me disa prej tyre te OSHP-ja te rifillimi i procedurave pasi të refuzohet ose nuk kryhet, është një afat dhjetë ditor për nisjen e procedurës së re, këto janë procedura në bazë të Ligjit. Por që ka keq planifikim, besoj që edhe kryetari dakordohet pavarësisht që buxheti përfundohet në muajin gushtë, dërgohet shtator në Kuvend, mundet mos me ja qellu saktë në promil, diçka pak mundet por jo në kaq masivitet. Sa i përket projekteve që nuk kanë fillua fare nuk është faji i Asamblesë, por është faji i ekzekutivit, i planifikimit, pastaj ai planifikim nuk përputhet me shpenzimin, nëse merret një analizë më e madhe shihet se në realitet në të gjitha rrugët që janë duke u punuar nuk e kemi asnjë tabelë dhe nuk e dimë se kur përfundon projekti, nuk e dimë a kanë teprua mjete financiare, sa janë shpenzuar. nuk po lidhet planifikimi me shpenzimin e parasë. Nuk po nisen procedurat, ju e dini që Ligji e thotë para përfundimit të kontratës duhet gjashtë muaj që të iniciohet procedura për kontraktim të

ri. Nëse ne veç i kemi mjetet atje, që kërkohet një pjesë për zotim të nisjes së procedurave, duhet të fillohen menjëherë e mos me pritë kur të përfundoj kontrata, se këtu po gabojnë në planifikimin dhe shpenzimin e parasë edhe po dalim te ky problem. Po na ndodh, është e dyta ose e treta herë këtë vit që i kemi ndërruar kodet, edhe vitin e kaluar kemi pas kështu rialokim dhe transfer, një prej projekteve, që besoj që ndërlidhet me pyetjen e kolegut tim z. Asllani thotë nga kodi 10/642/2, Shërbimet Kulturore, projekti Rritja e kapacitetit të ulëseve në palestrën sportive në shumën prej 30.000€, a kemi planifikim të këtyre 30.000€, në këtë kod, qysh u krye ajo procedurë e atyre ulëseve në palestër, a mundet dikush me na tregu, nëse është donacion, donacion i bashke financuar apo veç donacion, unë nuk e kam parë në faqe të komunës si donacion. Kjo ka të bëjë me pyetjen e kolegut tim, prandaj e pres një raport nga drejtori i ri i Kulturës në seancën e ardhshme. Ndërsa për pëlqim e tha edhe kolegu, është drejtori i urbanizmit që na tregon a ka marrë pëlqim për stabilitet të asaj palestere?

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim propozimin për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale.

Rezultati i votimit 20 për, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale.

Pika 3

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-mars 2024, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së Znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të Raportit financiar për periudhën janar-mars 2024, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Po fillojmë me realizimin e parë tremujor të vitit 2024 janar - mars, dhe po fillojmë prej tabelës së parë, tabela nr.1, ku janë të përfshira të dhënat statistikore që i ka siguruar ekzekutivi, këtu shihet se në kolonën e parë, del se përqindja e realizimit të planit të tremujorit të parë është 14.44 % mirëpo këtu është mirë me e cekë se duhet të bazohemi në shpërndarjen sipas kësteve dhe nëse merren bazë katër këste dhe gjitha këto të dhëna i ndajmë, i pjesëtojmë me katër, atëherë të dhënat ndryshojnë, ndryshohen bukur shumë dhe i afrohen realizimit që e kanë për obligim ekzekutivi. Po fillojmë prej administratës, sipas tabelës, në Drejtorinë e Administratës janë realizuar 9,450 €, kurse plani vjetor ka qenë 102,000 €. Tash, nëse 102,000 e ndajmë në katër këste, atëherë zbret në 25,500 €, dhe tash automatikisht me realizim të njëjtë përqindja del 76%, domethënë nuk del më 90%. Po vazhdojmë edhe te buxheti, për shembull nuk po i marr të gjitha me ju marrë kohë, por vetëm disa, sipas realizimit vjetor të planifikimit, 1,368,000 € nëse ndahen në katër këste, që e ka obligim ekzekutivi me raportuar, atëherë del se për këtë periudhë mujore duhet që të realizohet plani qind për qind, për këstin e parë 342,000 € dhe tash te përqindja nuk del në numër 75, por shkon në 79%. Disa drejtori e kanë tejkalluar, shembull çerdhja e fëmijëve. sipas tabelës nr.1 del se është 37%, nëse ndodh kjo se sa është e obliguar për këstin e parë, del 150%. Njëjtë vlen edhe te “Arkitekt Sinani” që ka për obligim vjetor 40,000 € me i siguruar, ka realizuar 13,432, domethënë përqindja del 33% sipas realizimit vjetor. Por, nëse ndahet në këste, atëherë del përqindja 134% te totali, domethënë ka dalë 14.49%. Mirëpo, nëse totali prej 3,285,000 ndahet në katër këste, atëherë kësti i parë i bie që të jetë 822,000 € dhe tash përqindja shkon në 58%, domethënë nuk është realizuar aq sa parashihet, meqenëse muajt e parë gjithëherë janë më të vështirë dhe ka telashe, sidomos te investimet kapitale, rialokimi i mjeteve fillon prej fundit të muajit mars, kështu që nuk ka mundësi as teorike me i shpenzuar mjetet pa i marrë se bëhet shkelje ligjore, kështu që në bazë të këtyre të dhënave mund të cekim se është pozitiv dhe nëse shikohet te kategoria ekonomike e pagesat, gjendja është shumë e mirë në bazë të përqindjes dhe vërehet se diku, sipas planit vjetor janë realizuar 22%, kurse nëse e ndajmë në këste, bie 88%. Te pjesa

përmbartimore që ka qenë temë çdoherë, është veç një kategori që janë marrë mjetet domethënë nuk ka asnjë operatorë ekonomik që ka dhënë vërejtje dhe i kanë mbetur faturat pa u realizuar, kjo është pozitive kurse ajo pjesa që është ngarkuar diku rreth 500,000 €, janë kryesisht për paga për shkak të ligjeve dhe procedurave që janë bërë prej vitit në vit.

Xhyljeta Imeri: Së pari ju falënderoj, por edhe ju kritikoj sepse që sa e kam kërkuar që të vendosen tabelat krahasuese me vitet paraprake, edhe këtë herë nuk i keni vendosë, ku po besoj, nëse i kishit vendosë, këtë herë kishit dalë më mirë se në vitin e kaluar, duke marrë parasysh që shpenzimet kapitale në vitin e kaluar i keni pas vetëm 5.48% për këtë periudhë kohore kurse në këtë vit e keni 9% e kështu që shpresoj që kjo vërejtje të rregullohet në periudhat të tjera ë gjithashtu edhe pse nuk është Drejtoria e Arsimit është kam pa një dallim tek pagat dhe mëditjet të gjitha janë 18, 24%, në përgjithësi në këtë drejtori. Vetëm në këtë drejtori janë 32% të shpenzuara. Çka është me rëndësi me ditë që në këtë drejtori më shumë se dy vite nuk është hapur asnjë konkurs për mësimdhënës. Me drejtë ligjore ka drejt vetëm një vit të merren ata kandidatë të cilët janë në listën pritëse dhe të vendosen në vendet ku kërkohen kurse këtu kanë kaluar më shumë se dy vite nuk është shpallë asnjë konkurs, unë besoj që këtu ka shkelje ligjore Kështu që ju kisha kërkoj nga ju dhe kisha e ka kërkuar që të diskutojmë se këtu diçka nuk është në rregull. Ndoshta një e dy nuk ankohen, por besoj që do të kenë ankesa ligjore.

Kryetari Bedri Hamza: Sa për sqarim, kur e shohim masën e pagave të shpenzuara te Drejtoria e Arsimit edhe shohim pjesën tek pagat përmes urdhrave përmbartimore d.m.th e rritin urdhëruar përmbartimor, që janë kryesisht si rezultat i shumë çështjeve të kontratave të ndryshme. Deri në këtë moment po ia jepi veç si informatë Komuna e Mitrovicës ka paguar për këtë vit, po flas veç për vitin 2024, afërsisht rreth 1.000.000 € si rezultat i kontratave kolektive nga e kaluara që ne e dimë komunat në këtë drejtim nuk kanë qenë nënshkrues dhe vazhdojnë me ardhur ende pagesa. Komunat po e paguajnë këtë kosto edhe pse realisht nuk janë pjesë e këtyre proceseve, po diskutojmë për shumë nuk po i hy specifikave, po e thamë që afërsisht rreth 1.000.000 € janë realizua përmes vendimeve përmbartimore dhe kështu vazhdon.

Xhevrije Bahtiri Ademi: z. Kryetar, marrëveshjen që e ke bë për këto pagesa, ka qenë e paraparë ekzekutimi të bëhet në muajin mars, por nuk janë bërë as 20% e pagesave dhe shumica e mësimdhënësve nuk janë me disponim të mirë për shkak që nuk janë bërë pagesat.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Unë kam pasur vullnetin, me qëllim të zvogëlimit të koston për komunën, që me i ikë disa shpenzimeve, mirëpo është numër i madh i personelit arsimor që ka zgjedhur rrugë tjera dhe nuk mundesh me shkua përtej asaj që e ka mundësua ligji, e kanë zgjedhë përmes rrugës ligjore, përmbartuesve e avokatëve dhe hyjnë në një proces të realizimit, një pjesë i kanë marrë, një pjesë pritet më i marr, na po diskutojmë, ku do të përfundoj mbetet me pa në fund. Unë thash se jam i bindur që 1.000.000 € janë realizuar deri tash do të thotë deri në muajin prill, ndërsa sa do të jetë shuma deri në fund të vitit këto do të na tregojnë evidencat. Pra është çështje që na s'mund t'a ndalim.

Hysen Muzliukaj: Po dua të ndërlihem me diskutimin e Kryetarit, Raporti është janar-mars do të thotë 521.612 € janë paguar, po i bie gati dhe po aq janë paguar veç që këto 29 ditë në prill edhe plus prapë ka ankesa që nuk janë paguar nga ajo marrëveshje. Kërkesa jonë ka qenë që të thesari tabelat të specifikohen si kanë qenë përpara drejtoresh, për arsye që edhe ne ti kuptojmë ma qartë për arsye se kur të na drejtohet ndonjë prej mësimdhënësve dhe të na thotë se nuk jemi paguar ne duhet ti kemi të qarta përgjigjet tona ndaj tyre, pra edhe një herë kërkoj që këto specifikime me na i sjellë. Meqenëse jemi tek raporti financiar, Kryetar, e kam ngritë një temë kohë më parë, kur e keni sjell raportin vjetor financiar, nëse ju kujtohet atë librin që u shtyp gabim, a e keni përmirësua atë libër, a ka shkua me ato gabim sepse ka qenë zotim nga kryetari që të ndryshohen të dhënat e pasakta.

Erseka Barani: Sa i përket raportit i kam dy shqetësime, njëra është tek Administrata e QKMF-së, ku tek mallrat dhe shërbimet janë të ndara 671.432 € ndërsa janë të shpenzuara 66% të kësaj shume, që i bien 441.084 €. Ne nuk e dimë se çka ka planifikua drejtori për gjysmën e dytë të vitit, meqenëse 66% janë shpenzua vetëm për tre muajt e parë, unë e di që përmes tyre mallra dhe shërbimeve bëhet edhe furnizimi me material shpenzues dhe barna esenciale për qytetarët dhe qendrat e mjekësisë familjare njëkohësisht, shqetësimi tjetër është që Kryetari në vazhdimësi përmend procedurat e prokurimit që marrin kohë, ndërsa tek Administrata e Arsimit janë të ndara 1.370.275 € në investime kapitale ndërsa ka zero realizim dhe shqetësimi kryesor është që tek investimet kapitale është vetëm 9% realizimi i tyre, kështu që është e vetmja kategori ose kategoria kryesore që i prek direkt qytetarët.

Fahri Shabani: Kjo ka ndodhë për shkak të Furnizimit prej Ministrisë së Shëndetësisë prej janarit deri në dhjetor 2023 kanë shkuar duke rënë dhe kanë qenë jashtë planifikimeve që na i kemi bërë, gjithashtu këtu janë krye disa pagesa për muajin dhjetor, që për shkak të mbylljes së buxhetit, nuk kanë mund mu ekzekutua si dhe janë bërë furnizimet nga QKMF-ja për komplet gjashtëmuajorin e parë që do të thotë kjo është arsyeja që ka ndodhë deri këtu. Na mendojmë se me një planifikim ma të mirë nga ana e menaxhmentit të QKMF-së, e kemi parapa me përfundua vitin, pa i zvogëlua shërbimet shëndetësore, furnizimet me materiale mjekësore po ashtu edhe me barna.

Ekrem Sadiku: Unë i kam si shqetësime disa çështje që kanë të bëjnë edhe me Raportin financiar edhe ndikimin e pagesave të mësimdhënësve që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Arsimit dhe çështjen e punësimit të planifikuar nga DKA-ja në Komunë. Atëherë pyetja ime është se a është bërë paralogari paraprake, meqenëse ka kosto financiare, te pagesat e mësimdhënësve për kompensim? Unë jam i informuar që të gjithë mësimdhënësit i kanë bërë ankesat për kompensim pra për të gjitha të cilat u potencuam këtu, mos t'i përsëriti që nga inflacioni, shujta, rruga tashmi së fundmi edhe ajo për kompensimin e orëve ose punën e vikendeve që kam punuar pra a është bërë një paralogari përafërsisht se sa do të jetë shuma?

Pastaj shqetësimi tjetër është pagesat të cilat do të marrim prej Organizatës Buxhetore e që e di që DKA s'ka mundësi, sepse s'ka mjete financiare që të kryejnë këto pagesa, a do të ndikojnë te punësime të cilat janë planifikuar në arsim, u potencua që qe dy vite s'ka pas konkurs deri më tani, pastaj në planifikim është që dy vite radhazi angazhimi i psikologëve, ka plot shkolla, ku kanë mungesë të kuadrove të mësimdhënësve, për shkak se nuk kanë mundësi t'i angazhojnë përpos shkollat e mëdha, që është gjimnazi dhe ekonomia, këtu do të thotë angazhojmë mësimdhënës mirëpo ky angazhim, ashtu qysh e tha edhe kolegja, unë me sa e di unë bie ndesh për shkak se lista e pritjes është njëvjeçare, andaj nuk mundesh ti me angazhua dikë pa konkurs, kur dihet që ky afat njëvjeçarë ka kaluar. Do të thotë, po gjitha këto pyetje, meqë drejtoresha nuk është këtu mirëpo i pres me shkrim, se cila do të jetë impakti e këtyre pagesave në planifikimet e DKA-së për vitin dy mijë e njëzet e katër.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2024.

Rezultati i votimit 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Raportin financiar për periudhën janar-mars 2024.

Pika 4

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin e punës së Drejtorisë së Shëndetësisë janar-dhjetor 2023, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DSH-së z. Fahri Shabani.

Pas arsyetimit të Raportit të punës së Drejtorisë së Shëndetësisë janar-dhjetor 2023, Kryesuesja e mbledhjes hap diskutimin.

Hysen Muzliukaj: Në seancën e kaluar nuk na ka ardhur raporti për shqyrtim, kam disa pyetje për drejtorin: Drejtori është mirë me na u përgjigj çka po ndodhë me furnizimin me barna për arsye se realisht kemi shpenzim shumë të madh të buxhetit, po në realitet ka mungesë të barnave, kjo është e evidente, këtë çështje e ka ngritë edhe kolegu im z. Veseli në një prej mbledhjeve të KPF-së. Domethënë, kemi tepër shpenzime, mirëpo në realitet kemi pak barna, a është duke u përdorë kjo kontratë jashtë barnave, apo çka ka ngecë?, është pyetja lidhur me këtë raport. E kam parë një karrige stomatologjike në publikim të drejtorit diku, a ka pasë në Facebook të vetin ose në media, karrigia stomatologjike është dhuruar prej operatorit që ka kontratë, kështu të paktën ka qenë informata në publik. Unë mendoj se nuk ish dashtë me kanë diçka e tillë, po flas nga ana ligjore, nuk ish dashtë me u pranuar qoftë edhe dhuratë një karrige stomatologjike prej operatorit me të cilin kemi kontratë, unë të paktën mendoj që kjo është gabim, unë nuk e kisha bërë dhe me qenë në vend të drejtorit s'e kisha pranuar. Drejtori publikisht ka dashtë me bë një bujë me rifillimin e dhënies së terapisë me infuzion në QKMF, po në realitet kohëve të fundit, javëve të fundit, jemi tu e pa një ballafaqim edhe një ankesë shumë të madhe me infuzionet, domethënë me shtretërit në QKMF. Atëherë, u kanë buja që s'ka ndodhë asnjëherë, po tash po kemi ankesa. A ka mundësi që të rriten shtretërit, a ka menduar drejtori për ndonjë zgjidhje të hapësirës tjetër, apo çka ka me ndodhë me këtë, se besoj edhe vetë e ka pa që nuk është duke shkua mirë, se ka radhë të gjata në pritje për marrjen e infuzioneve. Një gabim drejtshkrimor në raport është 2.3 “mbështja e policisë”, e kuptoj që keni dashtë me thënë mbështetja, po është raport për Kuvendin ish dashtë me kanë ma të më të vëmendshëm para tridhjetë e pesë asamblistëve. Drejtor, pyetja tjetër është: Çka ka ndodhë me QMF-në në Tavnik? E di që pas ndërtimit nga operatorët nuk janë pranuar punimet, sepse, sipas projektit që e kam dëgjuar, ka pas me u vendosë tullat, a është tu u zbatuar projekti fillestar, qysh e ka fituar operatori kontratën, se e di që nuk ka pas pranim, domethënë ka pas ngecje, edhe i dikush tash prej ekzekutivit ka thënë që s'bën. Edhe krejt në fund, një veturë Mitsubishi, që është pjesë e QKMF-së, a mundemi me ditë na si asamblistë ku mundemi me pa, po qe se duam për pesë minuta, dhjetë minuta ose a është në parkingun e komunës apo të QKMF-së, ku ndodhet ajo veturë Mitsubishi, ajo ka qenë për bartjen e vaksinave dhe është edhe veturë edhe është friz. Drejtor këtë përgjigje kisha pasur qejf me e jep të detajuar, në mënyrë që ta kem të specifikuar.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Kam një kërkesë nga shumë qytetarë për Drejtorinë e Shëndetësisë, sepse pika që ka qenë për furnizim me oksigjen me bombola tash është tërheqë dhe nuk ka në regjion hiç, edhe qytetarët duke filluar nga familja ime edhe shumë të tjerë, që kanë kërkesa për oksigjen, spitali nuk të jep, shtëpia e shëndetit nuk të jep, nuk kemi vend në spital ku t'i shtrimë nevojtarët për oksigjen. A ka mundësi që kjo Drejtori për nivel komunal të bëjë një kërkesë që në Regjion të jetë një vend për marrjen e këtyre bombolave me oksigjen për familjarët që janë të sëmurë në shtëpi, unë e di që pika e vetme është vetëm tek Lagja “Marigona” gati te Prishtina Mall. Unë po flas për veten time, si familje ke me shku e nuk kanë as bombola me të japë, vetëm atë çka ti e ke me vete, edhe tash, për një të sëmurë që do dy litra brenda ditës, për njëzet e katër orë e harxhon atë bombolë, e me çka me shku me marrë tjetrën, kur i sëmuri nuk pret. Kështu unë kërkoj që të jetë si prioritet kjo kërkesë tek Qeveria, apo kudo që të është e nevojshme, se vërtet qytetarët janë duke vuajtur shumë. Njëkohësisht desha me falënderuar Drejtorin sa i përket Shoqatës së Pedagogëve të Kosovës, sepse me të vërtetë ne jemi në hall, sepse unë jam edhe në atë bord, është i vetmi drejtor që të kthen përgjigje momentin kur i drejtohesh me një e-mail ose një kërkesë i vetmi që jep përgjigje edhe saktësisht na ndihmon është Drejtori i Shëndetësisë, edhe Drejtoria për Rini, Kulturë e Sport, edhe Drejtoria e Arsimit.

Erseka Barani: Përshëndetje për të gjithë, edhe unë desha me e përgëzuar Drejtorin e Shëndetësisë me të vetmin fakt që momentin që është bërë hapja e Spitalit pediatrik në hapësirat e spitalit dhe janë tërhequr nga objekti i QKMF-së këtu, atje është bërë e pamundur për me i pranuar fëmijët mbi moshën tre vjeç, mirëpo e di që në bazë të lajmeve çka kam mundur me pa, Drejtori

ka kërkuar takim me Drejtoreshën e spitalit atje dhe e ka bërë të mundur që tashmë fëmijët deri në moshën gjashtë vjeç të mund të vizitohen në Spitalin Pediatrik dhe të kontrollohen nga pediatër të cilët janë të angazhuar në atë spital. Kështu, faleminderit shumë Drejtor, në të vërtetë është një lehtësim shumë i madh për të gjithë prindërit. E përmendët që në këtë raport janë pesë objektiva, në fakt që ju jeni fokusua mirëpo në këtë raport nuk e pashë të përfshirë edhe dhënien e shërbimeve në mënyrë të detajuar, do të thotë në forma tabelare. Në këtë raport njëkohësisht thuhet: *zgjerimi i rrjetit të ordinancave në Kçiq dhe Fidanishte*, mirëpo sa herë në javë po ofrohet ky shërbim, sa herë më javë shkon stomatologu në këto dy qendra, njëkohësisht kam pas ankesa edhe nga qytetarët sa i përket dhomës së infuzioneve, para folësi veçse e ceku mirëpo përveç mungesës së hapësirës dhe shtretërve për marrjen e atij shërbimi ka mungesë edhe jo vetëm të ampulave, mirëpo edhe të materialeve bazike, kur qytetarët duhet vet me dalë me i ble ato, nuk e di a keni pas takime me Ministrinë e Shëndetësisë që të paktën ata t'ia u lehtësojnë punën dhe të mund t'iu furnizojnë me këto materiale bazike. Poashtu, desha me ditë, sepse nuk e pashë në këtë raport se në sa qendra ofrohet shërbimi i laboratorit apo diagnostikues dhe sa është numri i atyre shërbimeve që kryhen në këto qendra. Do të thotë ndoshta raporti është shumë në rregull, mirëpo disa specifika dhe detaje në forma tabelare mungojnë në këtë raport. Pastaj desha t'ju përgëzoj edhe për raportin e vizitave sistematike. Një shqetësim ke te rastet e patologjisë tek të pamurit e dobët, ku është mbi pesëdhjetë për qind, unë shpresoj që ky raport t'ju orientojë të krijoni një plan të punës, i cili do të ndihmonte njëkohësisht edhe shkollat, mirëpo edhe fëmijët dhe prindërit që të jenë më të kujdesshëm dhe ky numër për vitet e ardhshme të zvogëlohet si përqindje.

Hamdi Hasani: Për një punë të tillë, për një qasje të tillë, realisht, po të isha edhe unë në opozitë, do të veproja njëjtë si kolegët, do të godisja në pikën ma të fortë që me u mundu me zbeh pak. Të gjithë jemi dëshmitarë që në Mitrovicë ka ndodhë një transformim i pothuajse njëqind për qind të shëndetësisë në të gjitha lagjet, në të gjitha fshatrat, ambulanca të reja riparime, meremetime, qendra veç është gati në përfundim. Unë veç e përgëzoj drejtorinë, tash do të finalizohet kjo çështje dhe do të përmbillet me qendrën kryesore të mjekësisë familjare dhe besoj që për këtë çështje më nuk kemi as çka të diskutojmë as çka të debatojmë, sepse është e përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Fahri Shabani: U mundova me i mbajt shënim të gjitha pyetjet. Për anëtarin e Kuvendit, z. Hysen Muzliukaj, që pyeti a është duke u keqpërdorur furnizimet me barna, natyrisht se jo, furnizimi po vazhdon, furnizim ka, edhe barna ka në barnatoren qendrore të QKMF-së edhe në të gjitha mikro barnatoret e QMF-ve, normalisht nuk janë të gjitha barnat të cilat i kërkojnë qytetarët dhe të cilët ua përshkruajnë mjekët e kujdesit dytësor edhe tretësor pacientëve, janë shumica e barnave të cilat janë në listën esenciale. Karrigia stomatologjike si donacion, e cila është vendosur në QMF-së në Koshtovë, është ofrua si donacion, ka marrë mendimin e njerëzve kompetentë dhe e kemi pranuar me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, besoj që është gjithçka në përputhje me ligjin. Hapësira për dhënien e infuzioneve, jam i vetëdijshëm që ajo hapësirë është e vogël për nevojat të cilat i ka Mitrovica, atë hapësirë e kemi pasë në QKMF, nuk kemi tjetër hapësirë, ka qenë vullneti im me rifilluar pas shtatë viteve dhënien e infuzioneve, nuk ka ardhur si vendim i ynë për shkak të mungesës së hapësirës, po ka ardhur si vendim, rekomandim edhe obligim i Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës, që na ka obliguar me dhënë këtë shërbim. Normalisht, jemi duke i shikuar disa hapësira tjera për me i zgjeruar, po kjo është mundësia edhe kjo është hapësira, të cilën e kemi në dispozicion, sepse duhet me pas parasysh së gati gjysmën e hapësirës së QKMF-së, objekti i vjetër, shfrytëzohet nga spitali për ambulancat specialistike. Gabimet teknike që janë në raport, kërkoj falje, mundet me pas gabime teknike dhe drejtshkrimore. Nuk kemi lektorë që mundën me e lekturuar raportin. Sa i përket ndërtimit të QMF-së në Iliridë, ajo po ndërtohet sipas planit, normalisht, komisionet mbikëqyrëse i kanë punët e veta edhe sa herë që vërejnë që diçka del jashtë projektit normalisht që do të intervenojnë, do t'i japin vërejtjet e veta dhe gjithçka do të

implementohet, ashtu siç është në projekt. Ndërsa sa i përket veturës të cilën e përmendet, e cila është për shërbimin e vaksinimit, vetura është aksidentuar, po presim lidhjen e kontratës për servisim edhe riparim. Sa i përket pyetjes së zonjës Xhevrije Bahtiri Ademi për furnizimin me oksigjen duhet me biseduar sepse mund të ketë ndodhë ndonjë keqkuptim. Ne kemi kontratë për furnizim me oksigjen, ku kompania i merr bombolat e realizon mbushjen në pikën ku e ka dhe i sjell sipas kërkesës së QKMF-së. Me kërkesë të qytetarëve, normalisht ajo duhet me u përcjellë edhe me një raport mjekësor që është i nevojshëm aplikimi i terapisë me oksigjen në shtëpi. Ne i ndihmojmë qytetarët qoftë me mbushjen e bombolave, qoftë me dhënien e aparateve për oksigjen, të cilët i kemi në dispozicion në QKMF, për rastin konkret, unë jam i hapur me biseduar, le të vijë edhe e shqyrtojmë qysh ka qenë puna, po ju garantoj që ose bombolë ose aparat për oksigjenoterapi ne kemi me ia dhanë në shfrytëzim, sepse oksigjeni është shumë esencial. Hapja e pikave për furnizim me oksigjen është jashtë kompetencës tonë, mirëpo sa i përket furnizimit me oksigjen në QKMF sinqerisht po ju them nuk kam pasur asnjë ankesë. Shumë qytetarë janë drejtuar te unë, edhe unë i kam drejtuar tek zyrtarët e QKMF-së unë e kam për obligim, po e kam edhe si prioritet që këtë kërkesë tuajin me shqyrtuar bashkërisht dhe me e ditë ku ka probleme, edhe qytetari me e marrë ose një aparat funksional, ose bombolën me oksigjen. Ju falënderoj edhe për vlerësimin, për bashkëpunimin e mirë që e kemi me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike. Ju inkurajoj se sa herë që keni gara me më informuar dhe ekipi mjekësor dhe të jetë aty, ndërsa pyetjet e anëtares, zonja Erseka Barani për shërbimet në pediatri, fatkeqësisht Udhëzimet Administrative e thonë që edhe fëmijët prej zero deri në gjashtë vjet duhet me i marrë shërbimet e para te mjeku familjar, për mua është absurde, po udhëzimet e thonë ashtu. E kemi realizuar një takim, kemi gjetur mirëkuptim me Spitalin Regjional dhe fëmijët prej zero deri në gjashtë vjet vizitat i bëjnë pa udhëzim të mjekut familjar, direkt në repartin e pediatriisë, ndërsa të tjerët tek mjeku familjar. Sa i përket raportit të shërbimeve, ne e kemi këtë raport, me raportin e punës së QKMF-së nuk ua kam përcjellë për shkak të volumit të madh të dokumentit, mirëpo ai raport është publik në ueb faqen e komunës, ku janë të gjitha shërbimet, për gjitha repartet, për gjitha njësitë organizative, në qoftë se jeni të interesuar, unë jua përcjell Raportin e punës të QKMF-së për vitin 2023, ndërsa sa i përket ofrimit të shërbimeve stomatologjike në Kçiq dhe në Fidanishte, e di sigurt që në Fidanishte është një herë në javë, në Kçiq është më shumë se një herë në javë po me menaxhmentin e QKMF-së jemi marrë vesh që në bazë të numrit të pacientëve të ofrohet edhe numri i ditëve të cilat prezanton stomatologu aty, për dhomën e infuzioneve dhashë sqarimin. Kërkesat në Ministri të Shëndetësisë bëhen rregullisht nga ana e barnatores qendrore të QKMF-së ë nuk ka mungesë të materialeve për infuzione, mundet me pasur mungesë të barnave, sepse nëpër pesë për qind të infuzioneve që jepen në QKMP, ordinohej prej mjekëve të spitalit, prej mjekëve të QKUK-së, prej mjekëve nga klinikat private të cilat janë barna që janë jashtë listës esenciale, të cilat si posedon QKMF-ja dhe qytetarët duhet me kanë të vetëdijshëm për këtë që na nuk mundem me ble barna, për të cilat nuk është kompetent Kujdesi parësor shëndetësor. Shërbimet laboratorike, përveç QKMF-së, ofrohen edhe në QMF në Koshtovë, Stantërg dhe në QMF në Frashër, do të ofrohen edhe në QMF-në në Iliridë. Tek raporti i vizitave edhe mua më ka shqetësuar rezultati, duhet me pas parasysh që mjekët familjarë të cilët kanë shkuar në shkolla nuk mund ta caktojnë diagnozën përfundimtare. Atë e cakton specialisti i Oftalmologjisë, në këtë rast mjeku i syve, mirëpo, qëllimi ka qenë një diagnozë orientuese dhe t'i orientojmë ata fëmijë te të cilët është vërejt një çrregullim potencial jo definitiv që prindit ju ka dhënë informata dhe prindi pastaj e ka orientua tek mjeku i syve. I kam krahasuar edhe me komuna të tjera edhe me vendet e rajonit, janë përafërsisht aty që normalisht e dhëna që i kemi krejt raportin, po edhe kjo veçanërisht, është detyrë për neve që me i orientuar politikat shëndetësore të bazuara në fakte dhe në evidencë.

Erseka Barani: Mirëpo edhe shqetësimi tjetër ke higjiena jo e mirë e gojës tek fëmijët, përqindja ke tepër e lartë, gati pesëdhjetë për qind e këtu besoj që direkt kujdesi parësor, në bashkëpunim

me Drejtorinë e Arsimit mundem me e bë një plan më të detajuar edhe faktikisht me e ngrit vetëdijesimin edhe tek nxënësit, edhe tek fëmijët, mirëpo edhe tek prindërit, se sa e rëndësishme është.

Hysen Muzliukaj: Te vetura e aksidentuar a ka raport të policisë dhe a ndodhet në territorin e Komunës së Mitrovicës?

Fahri Shabani: Mendoj që duhet me pas raport të policisë, të informojë dhe në qoftë se është e lejuar me ta përcjellë, ta përcjelli raportin.

Kryesuesja Vesa Broja: Faleminderit gjithëve për kontributin sa i përket raportit të shëndetësisë.

Raporti, si i tillë, nuk votohet, kështu që po vazhdojmë me pikën e radhës së rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesja lidhur me Kërkesën për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës, e hapi diskutimin.

Sevdaim Uka: Sa i përket kësaj kërkesë unë nuk i jap vetit të drejtë që ta votoj deri sa nuk na ka vjen ndonjë raport i detajuar sepse kështu si ka ardhur si kërkesa është shumë e thjeshtë, unë asnjëherë nuk jam kundër stafit civil, unë jam pro stafit civil çdo herë mirëpo ti jepem 5.000€ me një kërkesë të thjeshtë edhe një herë po e potencoj se nuk ja jepi këtë të drejtë vetës.

Faruk Mujka: Parimisht ne pajtohemi me z. Uka po edhe të gjithë ne e dimë këtu që aktivitete të tilla ka pasur edhe më herët dhe janë financua ndonjëherë prej ekzekutivit, asamblesë, mendoj që ka qenë traditë edhe nuk është që na bën fort nder, në qoftë se jua ndërprejmë ne këtë traditë posaçërisht tash që e dimë se kryetari i sindikatës këtë vit shkon në pension dhe në qoftë se është një lloj organizimi i lamtumirës e që me u përfshi edhe një falënderim për aktivitetet e tij gjatë këtyre viteve. Unë mendoj, edhe pse ndoshta nuk i përmbush të gjitha kriteret çka kërkohen, dhe ne si Kuvend si shenjë falënderimin për aktivitetin e tij, sepse të gjithë kemi bashkëpunua me te dhe me sindikatën, kështu që po i mbyllim sytë nga pak.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës në vlerë financiare prej 5.000€.

Rezultati i votimit 24 për, 0 kundër dhe 1 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar me shumicë votash Vendimin për mbështetje financiare për sindikatën e të punësuarve në Komunën e Mitrovicës në vlerë financiare prej 5.000€.

Pika 6

Kryesuesja lidhur me Kërkesën për subvencionimin e botimit të librit me titull “555+” të autorit të njohur të Kosovës Z. Ilaz Bylykbashi, e hapi diskutimin.

Nafije Rexha: Sa i përket kësaj kërkesë e cila na ka ardhur pikërisht nga Komandanti, nga ai i cili ka kontribuar në çështjet e luftës, përderisa në këtë libër ofrohen fakte dhe dëshmi që nga paslufta, domethënë komplet proceset se si kanë rrjedhur dhe me vetë faktin që edhe kategoritë e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës kërkojnë që lufta e UÇK-së të hyjë në plan programet mësimore. Andaj me vullnetin më të madh e përgëzoj Kryetarin që e aprovoj edhe besoj që për Kuvendin është një diçka shumë e shenjtë dhe shumë e vlefshme që ta votojmë që një veprimtari kaq të mirënjohur dhe kaq të mirëpritur nga secili qytetar jo vetëm Mitrovicës, po i mbarë Kosovës!

Armend Begu: Unë kam një pyetje për z. Preteni, kjo iniciativë a është vetëm për Komunën tonë apo edhe për komunat tjera? Sepse ne të gjithë e dimë që figura e z. Ilaz Bylykbashi është një figurë mbarëkombëtare, pra i kalon kufijtë e Kosovës dhe ne qysh nga fëmijëria e kemi pa

kontributin e ti dhe e përkrahim pa rezervë, nëse është nevoja e ndihmojmë edhe ne kontribuojmë personalisht.

Kryetari Bedri Hamza: Falënderoj edhe diskutimet paraprake dhe besoj që kenë secila prej tyre ma korrekte se tjetra, po ta sqarojmë, pavarësisht respektit ndaj figurës së Z. Bylykbashi, pra nuk është qëllimi Z. Bylykbashi, qëllimi është tek materialet të cilat kanë me u publiku prandaj është sponsorizimi prej Kuvendit të komunës së Mitrovicës, e them sponsorizues me supozimin që i merr votat e Asamblesë. Nuk kemi të bëjmë ne me asnjë komunë tjetër me asnjë institucion tjetër, na u është drejtuar, e kemi sjell në Kuvend, Kuvendi vendos, nëse Kuvendi e qetë votën pozitive, do të thotë pagesa kryhet prej buxhetit të Komunës së Mitrovicës edhe libri që ka me u botua me fotografi, nuk e di cilat fotografi kanë me qenë, po e di që janë prej vitit 1980 e një proceset politike e deri në përfundimin e luftës do të thotë do të jetë sponsor i këtij libri Komuna e Mitrovicës, pra kanë mu publiku foto që nuk i ka pa opinionin hala deri më tani. Kuptohet gjithmonë me përkrahjen tuaj po them dhe ua atribuoj edhe meritat edhe për klubet sportive, OJQ-të, fermerët e çështjet tjera.

Kryesuesja Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim vuri në votim Kërkesën për subvencionimin e botimit të librit me titull “555+” të autorit të njohur të Kosovës z. Ilaz Bylykbashi. Në vlerë prej 15.000€.

Rezultati i votimit 26 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për subvencionimin e botimit të librit me titull “555+” të autorit të njohur të Kosovës Z. Ilaz Bylykbashi, në vlerë prej 15.000€.

Pika 7

Naser Muja: I kam dy pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike.

Çka po ndodh me ndriçimin publik në Mitrovicë? Të gjitha lagjet janë në terr.

Pusetat kah liqeni akumulues, është hera e tretë që dy vite që e ngriti këtë shqetësim, e patëm rastin që para disa ditë ra një fëmijë i vogël në pusetë, andaj kërkoj që mos të përsëritet dhe mos të na ndodhë më se kur të ndodhë, atëherë po bëhet vonë.

Amend Begu: Është një pyetje që ka qenë edhe më herët, pyetje dhe kërkesë, fjala është për Rrugën Rifat Dedija e cila është në gjendje tepër të keqe, aty ka rrezik potencial për një shembje, në fakt aty është shemb, dhe mundet prapë mu shemb gjatë qarkullimit të automjeteve. Më herët e kam ngritë këtë problematike, mirëpo këtu është thënë që ka probleme ose kontest pronësor, unë e kuptoj që mundet me pas problem pronësor por nëse është në pyetje me u zgjerua rruga pajtohem që mundet me qenë ai problem, por ajo është rrugë ekzistuese dhe ajo do të jetë prapë, mendoj që është mirë me intervenua derisa s'ka ndodhë ndonjë aksident ose diçka që mund të ketë edhe pasoja me fatalitet.

Kërkesa tjetër është për Rrugën “Xhafer Bistrica” në atë rrugë nuk ka as ujësjellës dhe as kanalizim sipas banorëve dhe banorët që jetojnë në atë pjesë e kanë të vështirësuar qarkullimin për shkak të ujit që del në rrugë dhe që rruga nuk është e kubëzuar e në veçanti e kanë problem dy persona që janë në hemodializë të cilët për të shkuar për tretmanin e tyre në dializë po e kanë problem qarkullimin për shkak të rrugës që nuk është e rregulluar.

Një shqetësim tjetër po ashtu e kam ngrit edhe më herët, është fjala për Objektivin e shurdhmemecëve për rregullimin e qatisë, nëse është intervenua kërkoj që së paku me shkrim të na e sjellin një informatë në mbledhjen e radhës.

Çështja e parkingjeve mbi trotuare të cilat në njëfarë mënyre janë legalizuar, problemi është që qytetarët nuk kanë se nga të ecin, aty janë legalizuar parkingjet, por nuk janë legalizuar për qytetarët, por janë legalizua për banorët rezidentë, pra i kemi gjithandej pengesat, ku ata i kanë bërë i mbajnë bizneset. Unë mendoj se nëse është parking që lejohet me parku veturat, edhe nuk e

cenon këmbësorit kalimin, atëherë duhet me qenë e lejuar edhe për qytetarët parkimi. Kërkoj një sqarim me shkrim rreth këtyre parkingjeve.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit të na e sjellin një raport financiar për vitet shkollore 2022/2023 dhe 2023/2024.

Granit Tmava: Ne si Komunë dhe si Drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë veçse sot kemi dalë në terren, pra dita e parë pas një pauze të thënë për shkak të mos furnizimit me kontratë për rregullimin dhe riparimin e ndriçimit publik, kemi filluar me përmirësime në gjithë Qytetin. Tani më në çdo lagje në të cilën kemi pasur probleme do t'i kthehet ndriçimi publik, qofshin ato parqe apo rrugë të caktuara. Sa i përket pusetave, është një sfidë me të cilën jemi duke u përballuar si qeverisje sepse po vjen deri te demolimi apo dëmtimi, mos të them edhe i qëllimshëm i këtyre pusetave për interesa të tjera, jemi duke vëzhguar, vazhdimisht jemi duke bërë përmirësimin dhe kthimin e tyre në gjendje të mëparshme, mund të ketë ndonjë të cilën veçse nuk kemi arritur të vijmë deri te përmirësimi i asaj gjendje, mirëpo jemi të hapur për çdo bashkëpunim. Në fund të ditës jemi këtu për një interes të përgjithshëm për të gjithë qytetin e Mitrovicës. Sa i përket shqetësimeve të z. Begu i cili i pati disa kërkesa, për trajtimin e Rrugës Xhafer Bistrica me Kubëza, është një kërkesë në të cilën ne veçse e kemi biseduar, i kemi nisur të gjitha procedurat që brenda këtij viti të furnizohemi me kontratë për rregullimeve apo riparimin e të gjitha rrugëve me kubëza, në momentin e parë që ne arrijmë të furnizojmë me kontratë, besoj shumë që do të përgjigjemi me trajtimin e kësaj rruge. Sa i përket parkingjeve të rezervuara, janë të trajtuara me ligj, e kanë të drejtë me ligj që në momentin që një trotuar me një hapësirë më të gjerë dhe ka hapësirë edhe për këmbësor edhe për parking të veturave, atëherë mund të shfrytëzohet nga të dy anët, nuk besoj që ka një vend apo hapësirë të caktuar, ku është i bllokuar hapësira për këmbësor dhe i jepet e drejta një veture, asnjëherë kjo nuk ndodh, aty ku është e jashtëligjshme besoj që Inspekcioni do t'i marrë të gjitha masat deri në lirim të asaj hapësire pra ka ndodh edhe sot ndodh ku Inspekcioni i Komunës së Mitrovicës është aktiv, duke liruar të gjitha hapësirat të cilat janë ngarkuara apo e bëjnë në trotuarin të ngarkuar dhe rrezikojnë këmbësorin për kalim të rrugës.

Armend Begu: Drejtor, pyetja ime është se a kemi të drejtë edhe ne qytetarët me parku veturën në ato parkingje në trotuar të cilat janë të lejuar se ka hapësirë të mjaftueshme edhe për këmbësorët apo vetëm banorët rezident.

Granit Tmava: Nëse jemi duke folur për ndërtesën kolektive tek Muzeu, atëherë vjen kërkesa si objekt kolektiv prej banorëve, të cilët e kërkojnë një hapësirë të caktuar kudo që është apo çfarë do të jetë dhe pastaj janë procedura tjera të cilat duhet të ndjekin, janë organet kompetente që merren me atë pjesë pra vijnë tek vendi i ngjarjes për identifikimi se a ka mundësia apo jo, atëherë pas identifikimit ipet përgjigja për të gjithë varësisht lokacionit.

Kryesuesja Vesa Broja: Për gjitha pyetjet tjera që i parashtron dhe nuk merret përgjigje, i drejtojmë pyetjet me shkrim dhe shpresoj që do t'i merrni përgjigjet me shkrim.

Gazmend Asllani: Unë para gjashtë muajve kam kërkuar një raport nga Drejtoria e Sportit edhe ende s'kam kurrfarë përgjigje as raport, ku është problemi, a mundem me më njoftua. Unë e di që ka pas ndryshime në këtë drejtori, por të presim për një raport janë shumë, është diçka e tepërt. Nëse s'ka raport është mirë të na thuhet nuk ka raport, një përgjigje e kemi marr po unë kam kërkuar një raport të detajuar për rrjedhën e krejt procedurës se si ka ardhur deri te përfundimi i vendosjes së tribunës, po ashtu kam kërkuar edhe nga Drejtoria e Urbanizimit se a ju është dhënë leja për ndërtim të asaj tribune. Pra përgjigje nuk kam marr as nga Drejtoria e Urbanizimit. Pra unë prapë kërkoj që të na sillet Raport i detajuar nga DKRS dhe nga DPU-ja, pres përgjigje.


Për drejtoreshën e Arsimit, kam një pyetje në lidhje me bursat për Shkollën e Mesme “Arkitekt Sinani”, ku është procesi, a mundë të na tregoni, Vitin e kaluar në këtë Kuvend e kemi votuar vendimin për bursat për nxënësit e shkollës “Arkitek Sinani” dhe ende as një hap nuk është ndërmarr ata nxënësit veç se e përfunduan vitin shkollor tash janë maturantë.


Po ashtu më intereson, pse katër shkolla të qytetit janë pa Sekretarë të shkollave qe katër vite, a mundemi me ditë pse? a kërkohet aq shumë kohë për një përzgjedhje të sekretarëve kur të gjithë e dimë se sa janë të nevojshëm sekretarët në shkolla. Pres përgjigje me shkrim meqenëse nuk është drejtoresha prezentë.

Kryesuesja Vesa Broja: Sa i përket raportit, drejtor ju kisha lutur që me marrë informacion për çështje që i ka ngritë z. Asllani. Nëse është e nevojshme, i merr pyetjet edhe në Sekretari, të cilat i ka ngrit atëherë po ashtu edhe tash. Ndërsa sa i përket bursave ne e kemi votuar Rregulloren për bursa këtu bashkërisht. Ajo Rregullore tash veç ka hy në fuqi dhe tash po besoj që drejtoresha fillon me u marrë me formimin e komisionit sepse deri më tani nuk ka pasur mundësi sepse nuk ka pasur Rregullore për me bë përzgjedhjen.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 12:22 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

